

REZOLUTË
PËR MIRATIMIN E PËRKUFIZIMIT TË PËRDORSHËM PËR
ANTISEMITIZMIN, PËRCAKTUAR NGA ALEANCA NDËRKOMBËTARE PËR
PËRKUJTIMIN E HOLOKAUSTIT

Kuvendi i Shqipërisë, duke marrë në konsideratë:

- Rezolutën e Parlamentit Evropian “Për luftën kundër antisemitizmit”, miratuar më 1 qershor 2017 (2017/2692(RSP));

- Deklaratën e Këshillit të Bashkimit Evropian “Për luftën kundër antisemitizmit dhe zbatimin e një përqasjeje të përbashkët për çështjet e sigurisë për të mbrojtur më mirë komunitetet dhe institucionet hebraike në Evropë”, bërë më 6 dhjetor 2018;

- Konkluzionet e konferencës së nivelit të lartë për luftën kundër antisemitizmit në hapësirën e OSBE-së, organizuar nga Kryesia e radhës shqiptare në Tiranë, më 4–5 shkurt 2020, miraton përkufizimin e përdorshëm për antisemitizmin, jo të detyrueshëm ligjërisht, të përcaktuar nga Aleanca Ndërkombëtare për Përkujtimin e Holokaustit, sipas të cilit:

“Antisemitizmi është një perceptim i caktuar për hebrenjtë, i cili mund të shprehet si urrejtje ndaj hebrenjve. Manifestimet retorike dhe fizike të antisemitizmit drejtohen ndaj individëve hebrej ose jo hebrej dhe/ose ndaj pronës së tyre, ndaj institucioneve dhe objekteve fetare të komunitetit hebraik.”.

Kuvendi vlerëson se:

Përkufizimi i përdorshëm, sikurse është përcaktuar nga Aleanca Ndërkombëtare për Përkujtimin e Holokaustit në seancën plenare zhvilluar në Bukuresht, në datën 26 maj 2016, në frymën e Deklaratës së Stokholmit, që thotë: “Me njerëzimin që ende është i frikësuar nga ... antisemitizmi dhe ksenofobia, komuniteti ndërkombëtar ka një përgjegjësi serioze për të luftuar këto të këqija”, ndihmon për të shquar më qartë e luftuar më me efikasitet antisemitizmin bashkëkohor.

Ky përkufizim përbën një instrument efikas në luftën kundër antisemitizmit në formën e tij moderne, për sa i përket manifestimit të urrejtjes ndaj shtetit të Izraelit, justifikuar me perceptimin e tij si një kolektivitet hebraik.

Kuvendi i rekomandon qeverisë shqiptare:

- Ta përdorë këtë përkufizim pune mbi antisemitizmin, jo të detyrueshëm ligjërisht, të përcaktuar nga Aleanca Ndërkombëtare për Përkujtimin e Holokaustit, si një instrument orientues në fushën e edukimit, si dhe për mbështetjen e autoriteteve juridike dhe ndëshkimore në përpjekjet e tyre për zbulimin dhe goditjen me efikasitet të sulmeve antisemitike.

- Të vazhdojë dhe të forcojë luftën ndaj çdo shfaqjeje të intolerancës dhe diskriminimit, që mund të çojë në akte urrejtje dhe dhune, përfshirë edhe antisemitizmin.

- Të rrisë masat sensibilizuese dhe edukative në kuadrin e luftës kundër manifestimeve të intolerancës dhe diskriminimit, përfshirë dhe antisemitizmin.

Miratuar në datën 22.10.2020

KRYETAR
Gramoz Ruçi